

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. Natasha Përpunja

Në përgjigje të kërkesës tuaj, me nr. 7405 prot., datë 13.09.2023 drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në të cilën kërkonti të qartësoheni mbi përfitimin e kompensimeve të energjisë elektrike në masën e pensionit, pasi nga ekstrakti i bankës keni konstatuar se për vitet 2015 – 2018 keni përfituar kompensimet për energji elektrike në pension dhe nga viti 2018 deri në muajin gusht 2023 nuk i keni përfituar, ju sqarojmë si në vijim:

Referuar sistemit të pagesave të pensione PCAMS, ju jeni përfituese e kompensimeve të energjisë elektrike në shumën 640 lekë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 565, datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike” të ndryshuar dhe e kompensimit të energjisë elektrike në shumën 648 lekë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj”, të ndryshuar, që nga data 1.07.2015 e në vazhdim.

Për periudhën janar 2018 - gusht 2023, pagesat e kompensimit të energjisë elektrike sipas VKM nr. 565, datë 09.08.2006 dhe VKM nr. 8, datë 14.01.2015 janë gjeneruar çdo muaj në llogarinë tuaj në bankën Credins ndërsa pagesa e muajit Shtator 2023, do të gjenerohet në bankë pas datës 20.09.2023.

Për të gjitha pagesat e periudhës janar 2018 - gusht 2023, që Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ka transferuar në llogarinë tuaj në bankën Credins, bashkëlidhur ju dërgojmë historikun e faturave.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Konceptoi: A. Shimaj

Miratoi: Xh. Koxhaj